



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



Pro Open

Koalicioni për Hapje të
te Dhenave dhe Llogaridhënie
në Prokurim Publik

Degradimi i vazhdueshëm mjedisor

2022

Degradimi i vazhdueshëm mjedisor



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!

Ky publikim është realizuar në Kuadër të Koalicionit për Hapje të të
Dhënave dhe Llogaridhënie në Prokurim Publik, mbështetur nga
Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur.



Deklaratë mohimi:

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e organizatës
Çohu! dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i
pikëpamjeve të donatorit.

Përpiluar nga:

Rina Koliqi

Publikuar nga:

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!

Rruga: Fehmi Agani 21-5; Prishtinë, Kosovë

Tel / +383 (0)38 248 506

www.cohu.org

preportr.cohu.org

opendata.cohu.org

PËRMBAJTJA

1. Shkurtesat	6
2. Metodologjia	7
3. Hyrje	8
4. Deponitë që nuk i plotësuan kriteret për leje të integruar mjedisore	9
5. Degradimi i vazhdueshëm i shtretërve të lumenjve	12
6. Dëme të mëdha nga gurthyesit në mjedis	15
7. Degraduesit e mjedisit po “amnistohen”	18
8. Përfundimi	21
9. Rekomandimet	22

1. Shkurtesat

KMDK → Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë

KPMM → Komisioni për Miniera dhe Minerale

MMPHI → Ministria e Mjedisit, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturës

KEK → Korporata Energjetike e Kosovës

KGJK → Këshilli Gjyqësor i Kosovës

2. Metodologjia

Ky publikim është rezultat i hulumtimeve, intervistave dhe shkrimeve të cilat tregojnë mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë, të cilat janë realizuar nga Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr e cila funksionon në kuadër të Organizatës Çohu!.

Si burime primare të këtij publikimi janë përdorur disa hulumtime të realizuara vite më parë nga Preportr e të cilat janë:

“Llumi jonë”, shkrim ky i publikuar në vitin 2014 nga Preportr i cili tregon rreth gjendjes së deponive të mbeturinave në Kosovë, si dhe rrezikut në disa aspekte i cili kanoset nga këto deponi.

“Industria e Shkatërrimit”, ky hulumtim që është publikuar në vitin 2019 trajton degradimin e mjedisit nga gurthyesit dhe eksploatuesit e zhavorrit. Gjithashtu janë hulumtuar të gjitha kompanitë që kanë marrë licenca për eksploatim të rërës, zhavorrit dhe gurit, për të parë lidhjet e tyre me partitë politike dhe është gjetur se disa nga operatorët janë të afërt me zyrtarët shtetëror, partitë politike dhe politikanët. Një pjesë e tyre janë evidentuar se janë edhe finances të partive politike.

“Fati i zi i Drinit të Bardhë”, gjithashtu përmes këtij hulumtimi është pasqyruar gjendja e Drinit të Bardhë, i cili është lumi më i dëmtuar në Kosovës për shkak të eksploatuesve ilegalë të rërës dhe zhavorrit. Të dhënat dhe gjendja faktike aktuale janë përditësuar, pasi që Preportr ka realizuar disa hulumtime lidhur me degradimin e lumenjve në Kosovë.

“Amnistimi i degraduesve të mjedisit”, hulumtim ky i cili tregon dështimin e institucioneve të drejtësisë në mbrojtjen e mjedisit. Mijëra lëndë të cilat lidhen me fushën e mjedisit janë parashkruar ndër vite nga gjykatat e vendit, ndërsa nga prokuroritë e vendit shumë kallëzime penale janë hedhur poshtë pavarësisht se dëmet në terren janë evidente.

Si burime sekondare janë marrë për bazë intervistat e realizuara me KMDK, MMPHI si dhe të dhëna të tjera të cilat kemi arritur t'i grumbullojmë nga vizitat në terren të cilat i ka realizuar ekipi i Preportr.

Gjatë përgatitjes së këtij publikimi, ekipi i Preportr ka dalë në terren dhe ka shikuar gjendjen aktuale në terren të deponive, lumenjve dhe gurthyesve. Përmes këtij raporti është paraqitur gjendja aktuale, duke e krahasuar me atë të viteve paraprake.

3. Hyrje

Ajri i ndotur, degradimi i hapësirave të gjelbra, dëmtimi i shtretërve të lumenjve si dhe gjendja e deponive të mbeturinave janë disa probleme të cilat ishin dhe vazhdojnë të jenë të dukshme në Kosovë në vitet e fundit.

Preportr për vite me radhë ka realizuar hulumtime të ndryshme të cilat tregojnë gjendjen e mjedisit, ku janë evidentuar degradime të shumta, kryesisht nga operuesit ilegalë.

Për t'i parë ndryshimet ndër vite ekipi i Preportr ka vizituar përsëri deponitë e mbeturinave, lumenjtë në disa komuna si dhe lokacione të ndryshme të Kosovës në të cilat operojnë gurëthyesit.

Ndonëse kanë kaluar vite gjendja aktuale në terren vazhdon të jetë e keqe. Qindra hektarë të lumenjve vazhdojnë të jenë të dëmtuar nga eksploatuesit ilegalë të rërës dhe zhavorrit, shumë male, kodra dhe vende tjera mbeten të degraduara nga gurthyesit. Pra në vendet ku është operuar, gjendja me kalimin e viteve është edhe më e keqe.

Sipas raportit të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), sipërfaqja e degraduar e Drinit të Bardhë në vitin 2012, arriti në 1011.75 hektarë. Që nga ajo kohë, nuk është bërë më një vlerësim i tillë. Përkundër degradimeve të cilat po ndodhin në mjedis dhe të cilat janë duke rrezikuar mirëqenien, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve, autoritetet e vendit nuk janë angazhuar sa duhet në parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve të cilat po shkaktojnë pasoja të mëdha në mjedis. Në situatën aktuale nevojitet një qasje dhe vendosmëri e institucioneve shtetërore për të parandaluar degradimin mjedisor dhe njëkohësisht për të rehabilituar vendet e degraduara. E domosdoshme është që edhe lëndët që lidhen me mjedisin të kenë prioritet në aspektin e trajtimit, e jo të parashkruhen.

4. Deponitë që nuk i plotësuan kriteret për leje të integruar mjedisore

Deponitë regjionale të mbeturinave në Kosovë u ndërtuan pa asnjë studim dhe pa konsultim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Edhe përkundër investimit të dhjetëra miliona eurove, gjendja e këtyre deponive nuk është e mirë, ndërsa ka nga ato deponi që janë në gjendje tepër të keqe, rrezikojnë jetën e njerëzve dhe ndotin mjedisin, duke rrezikuar edhe ujërat nëntokësore. Asnjëra nga deponitë nuk i kanë plotësuar kushtet për leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit.¹

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës kishte aplikuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për t'u pajisur për leje mjedisore të integruar për deponitë në Prizren, Gjilan, Podujevë si dhe për deponinë e Prishtinës, e cila gjendet në Mirash.

Nga MMPHI, thonë se arsyet që deponitë regjionale nuk janë pajisur me leje të integruar mjedisore kanë të bëjnë me "mos plotësimin e kushteve mjedisore që këto deponi duhet t'i plotësojnë".²

Se këto deponi nuk janë të pajisura me leje mjedisore dhe me licencë është konfirmuar edhe nga KMDK. Sipas kësaj kompanie, "kriteret të cilat kërkohen për t'u pajisur me licencë janë të

gjëra dhe se kompania nuk mund të përballojë kostot e larta, që kanë pajiset me makineri të vçantë për secilën deponi".³

Megjithatë, edhe pse këto deponi nuk kanë plotësuar kushtet ligjore për të marrë leje të integruar mjedisore si dhe licencat përkatëse, të njëjtave po u lejohet të vazhdojnë aktivitetin e tyre.

Procesi i ndërtimit të deponive në Gjilan, Podujevë, Prizren dhe Mirash të Obiliqit kishte filluar që nga viti 2002 ndërsa këto deponi kanë filluar të pranojnë mbeturina nga viti 2005 dhe 2006. Kapaciteti i pranimit të mbeturinave të këtyre deponive ka qenë 700 deri në 6000 ton, varësisht nga deponia.

Sipas të dhënave të cilat i kemi pranuar nga KMDK, "të gjitha këto projeksione për pranimin e mbeturinave janë të tejkaluara dhe shumëfishuara si dhe jetëgjatësia e këtyre deponive ka përfunduar. Të gjitha këto deponi të cilat u ndërtuan, shërbejnë kryesisht vetëm për mbeturina sanitare".⁴

Deponitë që gjenden në Gjilan, Prizren dhe Podujevë janë në gjendje më të mirë, kurse deponia në Mirash vazhdon të jetë në gjendje shumë të keqe mjedisore.

1 "Llumi jonë", Preportr, maj 2014 - <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Llumi-jone-64>

2 Shënim: Nga përgjigjet në kërkesë ndaj MMPHI-së lidhur me deponitë, 16 shkurt 2022

3 Intervistë me Kryeshefin e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, Abdullah Haxhiu, intervistuar më 15 shkurt 2022, Prishtinë

4 Intervistë me Kryeshefin e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, Abdullah Haxhiu, intervistuar më 15 shkurt 2022, Prishtinë



Ekipi i Preportr gjatë vizitës që i ka bërë kësaj deponie, ka vërejtur se ajo nuk ka lagunë dhe se ngjitur me të ka sasi të madhe të ujit. Në këtë deponi nuk ka pasur sistem të vendosur të mbledhjes dhe trajtimit të gazrave ose të paktën të lirimit të gazit në ajër. “Kjo paraqet rrezik për shpërthim ose shkaktim të zjarrit si dhe rrezik permanent për mjedisin, rrezikim të aseteve shtetërore, por rrezik të madh për shëndetin dhe humbjen e jetës së njerëzve në atë mjedis”.⁵

Problemet rreth menaxhimit të deponisë së Mirashit kanë filluar që nga viti 2007. Në këtë deponi përveç ujërave të zeza, ka prani edhe të ujërave atmosferike, por edhe të një pjesë e ujërave nga lokacionet e KEK-ut, e cila për pasojë ka grumbullimin e madh të sasisë së ujërave nga viti në vit si dhe rrezikun që këto ujëra të vijnë në kontakt me ujëra nëntokësore. “Një gjë e tillë jo që do të ishte problem vetëm për mjedisin aty ku është por mund të paraqet që këto ujëra të kalo-

jnë tek lumenjtë dhe me paraqit një problem racional.”⁶

Gjithashtu, kjo deponi nuk ka pasur sistem të vendosur të mbledhjes dhe trajtimit të gazrave që krijohen nga mbeturinat ose të paktën të lirimit të gazrave në ajër, e që edhe kjo është paraqet një dukuri të dëmshme por më pak të rrezikshme.

Lidhur me gjendjen e deponisë së Mirashit, nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës thonë se gjatë këtij viti planifikohet të bëhet studimi i fizibilitetit për të pasur një pasqyrë se si do të veprohet më tutje. “Opsionet apo rekomandimet se çfarë do të bëhet me deponinë në fjalë do t’i kemi pasi të kryhet ky studim fizibiliteti”.⁷

Duke marrë parasysh këtë situatë, është e domosdoshme që të bëhet një zgjidhje sa më shpejtë, përndryshe mund të shkaktohet një kaos sa i përket deponimit të mbeturinave.

5 “Llumi jonë”, Preportr, maj 2014 - <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Llumi-jone-64>

6 Intervistë me Kryeshefin e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, Abdullah Haxhiu, intervistuar me datë 15 shkurt 2022, Prishtinë

7 Shënim: Nga përgjigjet në kërkesë ndaj MMPHI-së lidhur me deponitë, 16 shkurt 2022



Një tjetër aspekt që ka paraqitur shqetësim ndër vite është prania e personave të paautorizuar në deponi, sidomos në atë të Gjilanit. Aty shumë persona, përfshirë edhe fëmijë, vazhdojnë të mbledhin mbeturina të riciklueshme, duke rrezikuar shëndetin, por edhe duke rrezikuar jetën pasi që ata mbeturinat i mbledhin afër ekskavatorëve. “Në vitin 2017 një 23 vjeçar ka humbur jetën në këtë deponi, pasi që është shtypur nga ekskavatori”.⁸

Si situatë shqetësuese dhe e rrezikshme paraqitet përzjerja e mbeturinave sanitare me mbeturina medicinale nëpër kontejnerë. Këto mbeturina jo që nuk duhet të hedhen në kontejnerë nëpër vendbanime, por ato është e domosdoshme që të trajtohen paraprakisht para se të hedhen edhe në deponi të mbeturinave.

Mbeturinat medicinale shpesh përzihen me mbeturina të zakonshme komunale, gjithashtu transportimi i tyre nuk bëhet me mjete të për-

shtatshme transportuese, trajtimi final i tyre nuk bëhet në mënyrë të duhur dhe të kontrolluar dhe se menaxhimi i këtyre mbeturinave bëhet në mënyrë të paplanifikuar. Proceset gjatë të gjitha fazave nuk është duke u monitoruara nga organet përgjegjëse.⁹

Në Kosovë nuk ka deponi për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme, si vajrat e përdorura të automjeteve, bateritë, akumulatorët, mbeturinat spitalore, shtazore, barnat e skeduar, ambalazhi i substancave të rrezikshme, mbeturinat e gomës dhe plastikës, mbeturinat elektrike dhe elektronike, pesticidet e skaduar, etj.

Prandaj në këtë aspekt duhet menduar më shumë sa i përket ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave në njërin anë si dhe në anën tjetër krijimit të kushteve sa më të përshtatshme për mbeturinat që konsiderohen më të rrezikshme apo që kërkojnë një trajtim më të veçantë sesa mbeturinat sanitare.

8 “Vdekja e paralajmëruar”, Preportr, korrik 2017 - <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Vdekja-e-paralajmëruar-218>

9 Raporti i Auditimit mbi Menaxhimin e Mbeturinave, Prishtinë, gusht 2013

5. Degradimi i vazhdueshëm i shtretërve të lumenjve

Dëme të shumta mjedisore janë shkaktuar nga nxjerrja ilegale e rërës dhe zhavorrit për shumë vite. Dëmet mjedisore nga këto operime janë të shumta. Një dukuri e tillë ka rritur edhe rrezikun për përmbytje, janë dëmtuar shtretërit e lumenjve, duke përfshirë florën dhe faunën. Komunitet në të cilat janë identifikuar më së shumti raste ilegale për rërë dhe zhavorr janë Peja, Kamenica, dhe Gjakova.

Drini i Bardhë është lumi më i dëmtuar në Kosovë, ai u bë shënjestra dhe terreni më i kërkuar nga eksploatuesit ilegalë të rërës dhe zhavorrit, të cilët që nga paslufta vendosën makinerinë e rëndë përgjatë lumit. “Për pasojë sipërfaqe të mëdha të shtratit të këtij lumi janë degraduar.¹⁰ Sipërfaqja e degraduar e Drinit të Bardhë në vitin 2012, arriti në 1011.75 hektarë”.¹¹

Banorët e fshatrave përreth po i vuajnë më së shumti pasojat. Ata janë të rrezikuar nga gropat e mëdha që janë hapur afër shtratit të lumit dhe nga vërshimet. Institucionet kompetente nuk kanë arritur ta mbrojnë këtë lumë, por as lumenjtë tjerë. Ato në të shumtën e rasteve nuk ua konfiskojnë makineritë operuesve ilegalë, të cilët po vazhdojnë degradimin mjedisor. Edhe në rastet kur operuesit ilegalë janë kapur nga inspektorati duke operuar dhe rastet kanë shkruar në gjykata, një pjesë e madhe e lëndëve janë parashkruar.¹²

Gjatë realizmit të këtij raporti janë vizituar fshatrat e Rahovecit dhe Prizrenit, nëpër të cilët kalon Drini i Bardhë. Gjendja në terren tregon se shtrati i lumit është degraduar shumë. Operatorët ilegalë, pas gërmimeve kanë lënë pas shumë gropa dhe e kanë devijuar edhe shtratin e lumit.

Përveç dëmeve të lartpërmendura, banorët thonë se për shkak të dëmtimit të shtratit të lumit, gjatë stinës së vjeshtës dhe të dimrit shtëpitë dhe arat e tyre janë të rrezikuara nga përmbytjet.

Degradime të mëdha të shtratit të lumit janë bërë edhe në fshatrat Dejnë, Dobidol dhe Xërxë të Komunës së Rahovecit. Në të tri këto fshatra, gropat që janë lënë pas nga operuesit ilegal janë kthyer në deponi ilegale, ku tashmë po hedhen mbeturina të ndryshme, të cilat po e ndotin mjedisin përreth.

Ndërkaq, në fshatin Gexhë dhe Malësi e Vogël të Rahovecit, nga nxjerrja e rërës dhe zhavorrit janë formuar pellgje të gjata të cilat shkojnë paralel me lumin.¹³

Në fshatin Çifllak të Rahovecit kishte ndodhur një incident i rëndë në vitin 2004. Për shkak se institucionet përkatëse nuk kishin bërë asgjë për

10 “Fati i zi i Drinit të Bardhë”, Preportr, tetor 2021 - <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Fati-i-zi-i-Drinit-te-Bardhe-347>

11 Raport për gjendjen e ujërave në Republikën e Kosovës, Prishtinë 2015

12 Ibid

13 “Fati i zi i Drinit të Bardhë”, Preportr, tetor 2021 - <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Fati-i-zi-i-Drinit-te-Bardhe-347>

2015

Gjendja e shtratis të lumit Drin



2022



të ndalur operuesit ilegalë, një gjë të tillë kishin vendosur ta bëjnë banorët e fshatit. Ata kishin tentuar t'i ndalnin ekskavatorët që po gërmonin në shtratin e lumit, por hasën në rezistencë të armatosur nga operuesit ilegalë, të cilët ishin nga fshati Kramovik.

Nga ky konflikt mbeti i vdekur Q.Th rreth të 40'ave, i cili ishte njëri nga pronarët e kompanisë dhe u plagosën dy fëmijë të fshatit Çifllak.

Incidenti i vitit 2004 nuk ishte i fundit në këtë fshat, kjo për faktin se operimet ilegale nuk u ndalën asnjëherë. Në vitin 2015, L.L., banor i fshatit Çifllak, rreth të 50'ave, humbi jetën pasi që ra me traktor në njërën nga gropat që ishin hapur nga ekskavatorët afër lumit. Gropat e tilla vetëm sa janë shtuar ndër vite në këtë fshat, ndërsa banorët shprehen të shqetësuar se aty mund të pësojnë sidomos fëmijët e tyre.

Pra pasojat nga operimet ilegale janë të ndryshme dhe të shumta.

Edhe buzë Lumbardhin e Pejës, afër lumit janë të vendosur makineri për përpunimin e zhavorrit. Në afërsi të lumit janë disa gropa nga ku është nxjerrë zhavorr. Në lumenjtë e anës së Kamenicës ka shenja të dëmtimit të tyre, por ato nuk janë shumë të theksuara pasi në këtë rajon lumenjtë janë të vegjël.¹⁴

Komunat në të cilat janë identifikuar më së shumti raste ilegale të nxjerrjes së rërës dhe zhavorr janë: Gjakova, Peja, Rahoveci dhe Kamenica.¹⁵

Përkundër gjithë dëmeve të cilat janë shkaktuar në shtretërit e lumenjve të vendit nga operuesit ilegal, institucionet kompetente kanë dështuar në mbrojtën e mjedisit si dhe ndëshkimin e kryesve.



Edhe buzë Lumbardhin e Pejës, afër lumit janë të vendosur makineri për përpunimin e zhavorrit. Në afërsi të lumit janë disa gropa nga ku është nxjerrë zhavorr. Në lumenjtë e anës së Kamenicës ka shenja të dëmtimit të tyre, por ato nuk janë shumë të theksuara pasi në këtë rajon lumenjtë janë të vegjël.

14 "Industria e Shkatërrimit", Preportr, korrik 2019 - <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Industria-e-shkaterrimit-292>

15 Ibid



Gurthyesi në fshatin Çirez

6. Dëme të mëdha nga gurthyesit në mjedis


Mjedisi në Kosovë po rrezikohet edhe nga gurthyesit. Vetëm gjatë viteve 2015-2018 janë lëshuar 562 licenca për nxjerrje të gurit, rërës dhe zhavorrit. Preportr ka gjetur se janë evidentuar 495 raste ilegale gjatë viteve 2009-2018 për ushtrimin e këtyre veprimtarive.

Në fshatin Çirez për vite të tëra kompani të ndryshme kanë gërryer kodrat me qëllim nxjer-

rjen e gurit i cili pastaj do të përpunohej e shitej për ndërtimtari. Shteti është treguar i pafuqishëm në menaxhimin e kësaj industrie ku si rezultat i mungesës së mbikëqyrjes dhe kontrollit, një pjesë e konsiderueshme e bukurive të vendit janë degraduar. Ekipi i Preportr ka dalur në terren për të vizituar pjesën ku po punon gurthyesi. Një gropë jashtëzakonisht e madhe është hapur mes kodrave të fshatit.¹⁶

16 "Industria e Shkatërrimit", Preportr, korrik 2019 - <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Industria-e-shkaterrimit-292>

Donatorët e partive politike përfitues të licencave



- Arsim Rexhepi pronar i kompanisë "Abi" sh.p.k. ka dhënë donacion 5,000 euro për PDK-në në vitin 2010. Kjo kompani gjatë viteve 2017-2018 ka marrë katër licenca për gurë të fortë, tri për hulumtim dhe një për shfrytëzim.
- Naim Selmani pronar i kompanisë "Arbër-Geo" sh.p.k. ka dhënë donacion 2,000 euro për PDK-në në vitin 2010. Kjo kompani ka marrë një licencë për hulumtim për gurë të fortë.
- Kompania "Bajramaliu" Sh.p.k. ka dhënë donacion 1,000 euro për PDK-në në vitin 2009. Kjo kompani gjatë periudhës 2007-2014 ka marrë tri licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Basi Kçiku pronar i kompanisë "Company Bejta Commerce" Sh.p.k. ka dhënë donacion 10,994 euro për PDK-në gjatë viteve 2009-2010. Donacionet janë dhënë në emër të tij personal dhe në emër të biznesit. Kjo kompani gjatë periudhës 2005-2018 ka marrë tetë licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Kompania "Egzoni" sh.p.k. ka dhënë donacion 1,000 euro për PDK-në në vitin 2010. Kjo kompani në vitin 2016 ka marrë një licencë për hulumtim për rërë dhe zhavorr.
- Florim Zuka ish pronar i "Eti" sh.p.k. ka dhënë donacion 10,000 euro për PDK-në në vitet 2009 dhe 2011. Kjo kompani gjatë vitit 2018 ka marrë dy licenca për shfrytëzim të gurit të fortë. Kompania tani është në pronësi të djalit të tij.
- Kompania "Flori" sh.p.k. ka dhënë donacion 1,960 euro për PDK-në në vitin 2011. Kjo kompani gjatë viteve 2008-2016 ka marrë licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Naim Besimi pronar i kompanisë "Getoar" Sh.p.k. ka dhënë donacion 500 euro për PDK-në në vitin 2009. Kjo kompani në vitin 2011 ka marrë një licencë për shfrytëzim për gurë të fortë.

- Kastriot Fazlija pronar i kompanisë "Kastrioti" ka dhënë donacion 1,000 euro për PDK-në në vitin 2010. Kjo kompani gjatë viteve 2008-2014 ka marrë dy licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- "Klina-Cem" gjatë viteve 2017-2018 ka marrë tri licenca për gurë të fortë, dy për hulumtim dhe një për shfrytëzim. Ky biznes është në pronësi të biznesit R&Rukolli pronar i së cilës (Rrustem Rukolli) ka dhënë donacion 5,000 euro për PDK-në në vitin 2009.
- Lulzim Abazi pronar i kompanisë "LB - Ekoplan" sh.p.k. ka dhënë donacion 1,000 euro për PDK-në në vitin 2010. Kjo kompani gjatë viteve 2008-2011 ka marrë dy licenca për shfrytëzim për gurë të fortë. Gjithashtu një kompani tjetër në të cilën Lulzim Abazi ka qenë pronar (L&D Company) ka marrë një licencë në vitin 2017 për hulumtim për rërë dhe zhavorr.
- Mehmet Imaçaj pronar i kompanisë "Mermer Commerce 1" sh.p.k. ka dhënë donacion 1,000 euro për PDK-në në vitin 2010. Kjo kompani gjatë viteve 2008-2013 ka marrë dy licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Ndërmarrja Tregtare Shërbyese "Sedtoours" ka dhënë donacion 1,000 euro për PDK-në në vitin 2012. Kjo kompani ka marrë një licencë në vitin 2005 për shfrytëzim për gurë të fortë. Gjithashtu pronar i kësaj kompanie është bashkëpronar në kompaninë "Sedtoours" sh.p.k. e cila gjatë vitit 2016 ka marrë dy licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Rrustem Rukolli pronar i kompanisë "R & Rukolli sh.p.k." ka dhënë donacion 5,000 euro për PDK-në në vitin 2008. Kjo kompani në vitin 2008 ka marrë një licencë për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Kompania "Renelual Tahiri" sh.p.k. ka dhënë donacion 1,000 euro për PDK-në në vitin 2012. Kjo kompani gjatë viteve 2006-2017 ka marrë katër licenca për gurë të fortë, tri për shfrytëzim dhe një për hulumtim.

- Kompania "Fitorja" Sh.p.k. ka dhënë donacion 4,990 euro për PDK-në në vitin 2012. Ndërsa Tahir Maloku, pronar i kësaj kompanie ka dhënë 600 euro për LVV-në në vitin 2012. Kjo kompani në vitin 2016 ka marrë një licencë për hulumtim për gurë të fortë.
- Kompania "Badallaj 5 Sh.p.k." ka dhënë donacion 50 euro për LVV-në në vitin 2010. Kjo kompani në vitin 2013 ka marrë një licencë për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Nexhat Haziri pronar i kompanisë "Blok Group sh.p.k." ka dhënë donacion 313 euro për LVV-në në vitin 2013. Kjo kompani në 2017 ka marrë një licencë për hulumtim për gurë të fortë.
- Kompania "Etem Trade Sh.p.k." ka dhënë donacion 50 euro për LVV-në në vitin 2012. Kjo kompani gjatë viteve 2007-2010 ka marrë dy licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Kompania "I Seferi Sh.p.k." ka dhënë donacion 150 euro për LVV-në në vitet 2011-2012. Kjo kompani gjatë viteve 2013-2018 ka marrë katër licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Kompania "Vëllezërit e Bashkuar Sh.p.k." ka dhënë donacion 100 euro për LVV-në në vitet 2011-2012. Kjo kompani gjatë viteve 2006-2009 ka marrë dy licenca për shfrytëzim për gurë të fortë.
- Ramadan Gashi pronar i kompanisë "Ag - Group sh.p.k." ka dhënë donacion 500 euro për AAK-në në vitin 2016. Kjo kompani gjatë viteve 2014-2018 ka marrë tri licenca për gurë të fortë, një për shfrytëzim dhe dy për hulumtim.
- Enver Cacak pronar i kompanisë "Dekor sh.p.k." ka dhënë donacion 300 euro për AAK-në në vitin 2016. Kjo kompani në vitin 2018 ka marrë dy licenca për hulumtim për gurë të fortë.


Kompania përkatëse pas nxjerrjes së materialit ata nuk e kishin rivitalizuar tokën dhe si pasojë nga një hapësirë e gjelbër, ky vend është shndërruar në gërmadhë. Lidhur me këtë asnjë nga institucionet nuk kishte ndërmarrë ndonjë masë që parandalon rrezikimin e jetës së këtyre banoreve.

Komunat në të cilat janë identifikuar më së shumti raste ilegale për gurthyes janë Gjakova, Peja, dhe Kaçaniku. Ndërsa institucionet përgjegjëse nuk kanë asnjë raport që tregon për pasojat që janë shkaktuar në mjedis nga kjo veprimtari.

Në Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit, gurthyesit konsiderohen si njëri ndër ndotësit më të mëdhenj të ambientit. Përveç ndotjes së ambientit gurthyesit kanë shkaktuar dëme në disa raste në objekte të banimit.

Ekipi i Preportr ka dalë në terren për të parë disa nga gurthyesit se ku janë duke operuar dhe sa kanë ndikuar në degradimin e mjedisit përreth. Një pjesë e madhe e tyre operojnë në Komunën e Drenasit dhe të Klinës. Te kjo e fundit sidomos në fshatrat Gremnik dhe Gllarevë.

Kompani të afërta me parti politike përfitues të licencave



KOMPANITË E AFËRTA ME DEPUTETË PËRFITUES TË LICENCEVE

- "Rex Marble" gjatë vitit 2014 ka marrë tri licenca për shfrytëzim për gurë të fortë. Drejtori i kësaj kompanie Naim Rustemi ka qenë deputet nga radhët e PDK-së, gjithashtu ka qenë kandidat për deputet nga AAK.
- "AIM" sh.p.k. gjatë viteve 2013-2016 ka marrë licenca për hulumtim për gurë të fortë. Kjo kompani është në bashkëpunim të Mirëgjimis Lushitakut, deputet i PDK-së në Kuvendin e Kosovës, Mirëgjimis Lushitaku gjithashtu është djali i Sami Lushitakut kryetar i komunës së Skenderaj për disa mandate.
- "Trasing Group" sh.p.k. gjatë viteve 2006-2013 ka marrë tri licenca për shfrytëzim për gurë të fortë. Pronarët e kompanisë janë familjarë të deputetëve të PDK-së Sala Benisha Shala, gjithashtu Ferat Shala, bashkëshorti i deputetës ka deklaruar të hyra nga kjo kompani në vitin 2012.
- "Benita Company" sh.p.k. gjatë viteve 2006-2018 ka marrë shtatë licenca për gurë të fortë, katër për shfrytëzim dhe tri për hulumtim. Kjo kompani është në bashkëpunim të bashkëshortit të Mirëgjimis Kalludra e cila është deputete e LDK-së në Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu në formularët e pasurisë së deklaruar që punon si menaxher në këtë kompani.
- "SharrCem" sh.p.k. gjatë viteve 2013-2018 ka marrë katër licenca për gurë të fortë dhe një për rërë dhe zhavorr. Kjo kompani është në pronësi të kompanisë "Sharr betongbeton" gmbh, në të cilën ka qenë zyrtar deputeti i LDK-së Lutfi Zharku.

KOMPANITË E AFËRTA ME ZYRTARË PUBLIK PËRFITUES TË LICENCEVE

- "Goni-AL" sh.p.k. gjatë viteve 2016-2017 ka marrë dy licenca për gurë të fortë, një për shfrytëzim dhe një për hulumtim. Pronari i kësaj kompanie Luzim Aliu ka qenë këshilltar politik i z. kryeministrit Hajredin Kuqi, poashtu këshilltar komunal në komunën e Ferizajt dhe tani është drejtor në të njëjtën komunë.
- "Haxha Company" sh.p.k. gjatë viteve 2014-2018 ka marrë pesë licenca për gurë të fortë, tri për hulumtim dhe dy për shfrytëzim. Bedri Dobra që është drejtor në komunën e Vushtrisë nga radhët e PDK-së, punon si glodet në kompaninë "Haxha Kom" e cila për pronar e ka Haxhi Zenullahin i cili është pronar në kompaninë "Haxha Company".
- "Fenix Energy Company" L.L.C. gjatë viteve 2014-2015 ka marrë dy licenca për gurë të fortë, një për shfrytëzim dhe një për hulumtim. Artan Nimani, këshilltar komunal nga radhët e PDK-së në Gjakovë, ka qenë pronar në këtë kompani deri në vitin 2016.
- "KAG - Asphalt Company" sh.p.k. në vitin 2012 ka marrë një licencë për shfrytëzim për gurë të fortë. Menaxherja e kësaj kompanie, Sebare Malqi, është këshilltare komunale në komunën e Prizrenit nga radhët e PDK-së.
- "Mendi -P" sh.p.k. gjatë viteve 2010-2014 ka marrë dy licenca për gurë të fortë, një për shfrytëzim dhe një për hulumtim. Astrit Thaqi, ish pronar në këtë kompani është këshilltar komunal në Rahovec nga radhët e PDK-së dhe ka deklaruar të hyra si punëtor i kompanisë në AAK.
- "Orbita" sh.p.k. në vitin 2015 ka marrë një licencë për hulumtim për gurë të fortë. Luzim Rustemi është këshilltar komunal në komunën e Lipjanit nga radhët e PDK-së dhe gjithashtu është nënkryetar i degës së PDK në këtë komunë.
- "Erëza" sh.p.k. në vitin 2017 ka marrë një licencë për hulumtim për gurë të fortë. Pronari i kësaj kompanie, Mustafa Grainca, është zv. ministër në Ministrinë e Financave dhe këshilltar i kryetarit të komunës në Ferizaj nga radhët e PDK-së.
- "Korporata Projektuese Ndërtimore dhe Prodhuese Pro-ENG" sh.p.k. ka marrë një licencë në vitin 2016 për shfrytëzim për gurë të fortë. Rexhep Kadriu i cili ka deklaruar që e ka në pronësi këtë kompani, i njëjti është zv. ministër në M nga radhët e AAK-së.
- "Ma.Con" sh.p.k. gjatë viteve 2008-2018 ka marrë dy licenca për shfrytëzim për gurë të fortë. Kjo kompani është në pronësi të familjeve të Haki Rugoves i cili është kryetar i komunës së Istogut nga radhët e LDK-së, gjithashtu ai në të kaluarën ka deklaruar aksione nga ky biznes.

KOMPANI TË AFËRTA ME POLITIKËN PËRFITUES TË LICENCEVE

- "Green Power" sh.p.k. gjatë viteve 2015-2018 ka marrë nëntë licenca për gurë të fortë, tetë prej tyre për hulumtim dhe një për shfrytëzim.
- "Scope" sh.p.k. gjatë viteve 2016-2018 ka marrë pesë licenca për hulumtim për gurë të fortë. Pronarë të këtyre dy biznesëve janë Florije Rustemi dhe Sadije Rama. Florije Rustemi është grua e Naim Rustemit, ish deputet i PDK-së dhe kandidat për deputet nga AAK në vitin 2014. Sadije Rama është grua e Ilir Ramës, bashkëpronar me Mirëgjimis Lushitakut në biznesin "AIM".
- "Kodra" sh.p.k. gjatë viteve 2012-2017 ka marrë nëntë licenca për gurë të fortë, gjashtë prej tyre me hulumtim dhe tre prej tyre për shfrytëzim. Pronari i kësaj kompanie është Enver Zogaj i cili është vëllau i Blalim Zogaj, ish deputet i PDK-së. Gjithashtu Ramiz Krasniqi, drejtor në KPMK ka deklaruar të hyra e firmijes nga ky biznes.
- "Kofix" sh.p.k. në vitin 2008 ka marrë një licencë për shfrytëzim për gurë të fortë. Basi Ahmetaj, anëtar bordi në Kompaninë e Pastrimit Higjienja ka deklaruar në vitin 2012 që është person përgjegjës në kompaninë "Kofix". Gjithashtu grua e tij, Ibadete Burjak Ahmetaj ka qenë kandidat e PDK-së për asambleen komunale në Kamenicë në vitet 2013 dhe 2017.

Si në çdo sektor publik në Kosovë edhe në industrinë nxjerrëse shihet që kompanitë të cilat janë të afërta me subjekte politike janë përfituese të licencave nga institucionet përkatëse.

Preportr ka hulumtuar të gjitha kompanitë që kanë marrë licenca për eksploatim të rërës, zhavorrit dhe gurit për të parë lidhjet e tyre me parti politike. Lidhjet e kompanive me politikën fillojnë nga donatorët e subjekteve politike dhe

vazhdojnë deri në zyrtarë të lartë partiakë e institucionalë.

Nga 279 kompani të cilat kanë marrë licenca, Preportr ka gjetur se 42 prej tyre kanë lidhje me politikën. Këto kompani kanë marrë 116 licenca nga KPMK.¹⁷

7. Degraduesit e mjedisit po “amnistohen”

Edhe pse për vite të tëra janë bërë dëme të shumta në fushën e mjedisit, institucionet e drejtësisë nuk janë treguar të afta që të sjellin para përgjegjësisë kryesit e këtyre veprimeve.

Në të shumtën e rasteve degraduesit e mjedisit ia kanë hedhur lehtë. Një pjesë e madhe e tyre nuk janë zënë nga inspektorët duke operuar ilegalisht, e një pjesë e vogël që janë zënë, kanë shpëtuar pa u ndëshkuar sa duhet. Ata janë ndëshkuar me dënime të vogla, shumëfish më pak sesa dëmi që e kanë shkaktuar në terren.

Një pjesë e madhe e tyre kanë shpëtuar për faktin se lëndët e tyre janë parashkruar.

Parashkrimi konsiston në atë se për shkak të kalimit të afatit të caktuar me ligj, shteti e humbë të drejtën e ndjekjes së personave apo kompanive dhe rrjedhimisht nuk mund t’u shqiptohet dënim përveprat e kryera. Përvepra kundërvajtëse ky afat është dy vjet prej datës kur është kryer kundërvajtja, ndërsa për vepra penale, varësisht se sa është e dënueshme vepra, ky afat fillon të rrjedh nga një deri në më shumë se dhjetë vjet sipas kodit të ri penal.

Praktikisht, kjo do të thotë se një person apo kompani që i ka prerë ilegalisht pyjet, ka bërë gropa të mëdha duke nxjerrë gurë, ka degraduar shtretërit e lumenjve etj., është zënë nga inspektorati dhe është proceduar në gjykatë, por nuk është dënuar.

Një rast i tillë ka ndodhur edhe në fshatin Vrellë të Komunës së Istogut. Aty për shumë vite kanë operuar dy gurthyes dhe pas gërmimeve të shumta që i kanë bërë në atë lokacion, ato nuk e kanë rehabilituar vendin.

¹⁸Nga vizita që i kemi bërë këtij vendi shihet se nga gërmimet e bëra janë krijuar disa gropa të mëdha dhe dëmet mjedisore aty janë evidente. Aktualisht ky vend është shndërruar në deponi të mbeturinave inerte.

Njëra nga kompanitë kishte operuar aty që nga viti 2003, duke shkaktuar dëme të shumta në mjedis. Këtë e kishte konstatuar disa herë inspektorati i Ministrisë së Mjedisit. Ky inspektorat në vitin 2017 e kishte urdhëruar kompaninë ta bëjë rehabilitimin dhe rrethimin e vendit ku ka punuar për shkak se kishte bërë gropa të mëdha, por kompania nuk e ka bërë një gjë të tillë. Për këtë arsye në vitin 2018, pas riinspektimit, inspektorati e kishte dërguar rastin në gjykatë. Në gjykatë ishte dërguar edhe një kompani tjetër për të njëjtën arsye.¹⁹

Por siç po ndodh me shumë lëndë të mjedisit, të dy këto lëndë janë parashkruar nga Gjykata Themelore e Pejës – dega në Istog, e cila e ka pezulluar procedurën kundërvajtëse. Lidhur me këtë rast, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, por ankesa është refuzuar si e pabazuar.

18 “Amnistimi i degraduesve të mjedisit”, Preportr, shtator 2021 - <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Amnistimi-i-degraduesve-te-mjedisit-342>

19 Ibid



Gjendja e vendpunishtes në fshatin Vrellë pas përfundimit të operimeve nga gurthyesit



Në të shumtën e rasteve degraduesit e mjedisit ia kanë hedhur lehtë. Një pjesë e madhe e tyre nuk janë zënë nga inspektorët duke operuar ilegalisht, e një pjesë e vogël që janë zënë, kanë shpëtuar pa u ndëshkuar sa duhet. Ata janë ndëshkuar me dënime të vogla, shumëfish më pak sesa dëmi që e kanë shkaktuar në terren.

Kjo do të thotë se këta operatorë kanë shpëtuar pa dhënë asnjë përgjegjësi për degradimin që e kanë lënë pas.

Sipas të dhënave që Preportr i ka marrë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), rezulton se në periudhën 2015-2019 gjykatat e Kosovës kanë parashkruar 1630 lëndë penale për veprat “Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit”, “Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme”, “Lejimi i kundërligjshëm apo drejtimi i fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin”, “Shkatërrimi i pyjeve” dhe “Vjedhja e pyjeve”.

Pavarësisht se gjykatësit kanë parashkruar mijëra lëndë që kanë të bëjnë me dëmtimin e mjedisit dhe ka pasur ankesa ndaj tyre, të dhënat e siguruara nga KGJK tregojnë se deri më tani nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore ndaj asnjë gjykatësi për shkak të parashkrimit të lëndëve të mjedisit.

Siç duket edhe prokuroritë nuk kanë pasur vullnet të merren si duhet me ndjekjen penale ndaj degraduesve të mjedisit. Këtë e tregon edhe fakti se përveç Prokurorisë Themelore të Pejës, e cila ka caktuar prokurorët si koordinatorë për vepra të caktuara penale në mjedis, asnjë nga prokuroritë tjera nuk e ka bërë një gjë të tillë.

MËNYRA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE PENALE TË MJEDISIT NË
GJYKATAT THEMELORE TË KOSOVËS

	Denim me burgim	Denim me gjobë	Denim me kusht	Denime tjera	Me Akgjykim Lirues	Me Akgjykim Rrefuzues	Parashkruar	Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Gjithsej lëndë të zgjidhura
2015	101	596	404	110	21	97	495	218	2042
2016	154	648	569	50	30	64	470	457	2442
2017	49	609	402	73	26	61	337	210	1767
2018	90	501	422	31	35	71	181	193	1524
2019	23	503	305	47	21	61	147	228	1335
2015-2019	417	2857	2102	311	133	354	1630	1306	9110

Të dhënat e mësipërme janë për veprat penale: Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, "Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme", "Lejimi i kundërligjshëm apo drejtimi i fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin", "Shkatërrimi i pyjeve" dhe "Vjedhja e pyjeve".

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

8. Përfundime

Mjedisi në Kosovë është degraduar në masë të madhe si pasojë e operimeve të shumta ilegale. Shumë hektarë të shtretërve të lumenjve janë dëmtuar ndër vite në lokacione të ndryshme në Kosovë. Në anën tjetër dëme të shumta kanë shkaktuar edhe gurthyesit. Shumë vende ku ata kanë operuar kanë mbetur të parehabilituara. Gropat e mëdha që janë lënë pas, tashmë paraqesin rrezik edhe për banorët që jetojnë përreth.

Duke parë dëmet e shumta që janë shkaktuar në terren, mund të konstatohet se institucionet shtetërore kanë dështuar të mbrojnë mjedisin në Kosovë. Degraduesit e mjedisit nuk janë përgjigjur asnjëherë për dëmet që i kanë shkaktuar. Ndonëse Kosova ka një kornizë ligjore për mjedisin, implementimi i tyre nuk është i mjaftueshëm. Mbrojtja e mjedisit vazhdon të jetë një çështje e anashkaluar nga institucionet kompetente, andaj dhe arritja e synimit të zhvillimit të mirëfilltë si dhe mbrojtja e mjedisit duket që paraqet sfidë për institucionet shtetërore.

Sipas të dhënave të KGJK-së, të cilat janë siguruar nga Organizata Çohu!, rezulton se një numër i madh i lëndëve të cilat kanë të bëjnë me mjedisin, janë parashkruar nga gjykatat themelore të vendit. Vetëm përveprat “Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit”, “Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme”, “Lejimi i kundërligjshëm apo drejtimi i fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin”, “Shkatërrimi i pyjeve” dhe “Vjedhja e pyjeve” janë parashkruar 1650 lëndë penale për vitet 2015-2019. Ky numër i madh i rasteve të parashkrimit dëshmon

mungesën e efikasitetit të gjykatave në trajtimin e lëndëve të mjedisit.

Në anën tjetër, Prokuroria e Shtetit po dëshmon mungesë efikasiteti në hetimin e lëndëve të mjedisit, kjo për faktin se një numër i madh i kallëzimeve penale hedhen poshtë me arsyetimin se nuk ka prova të mjaftueshme, përkundër faktit se dëmet në mjedis janë evidente.

Se ndjekja penale mund të ketë efekt në parandalimin e krimit ndaj mjedisit, e vërteton Prokuroria Themelore në Pejë e cila ka caktuar prokurorë koordinatorë për disa vepra penale kundër mjedisit. Caktimi i prokurorëve koordinatorë ka dhënë rezultate shpresëdhënëse për mjedisin, sidomos me sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve të përdora gjatë kryerjes së këtyre veprave penale. Një praktikë të tillë nuk janë duke e përdorur prokuroritë tjetra në vend.

Në anën tjetër edhe deponitë regjionale të mbeturinave nuk janë në kushte të mira mjedisore. Ato që nga ndërtimi kanë funksionuar pa leje të integruar mjedisore. Në gjendje tejet të keqe mjedisore është deponia e Mirashit. Kjo deponi ka nevojë për një menaxhim të mirë, në mënyrë që të mos shkaktojë pasoja mjedisore, sidomos me ujërat përreth e në veçanti ato nëntokësore. Këto deponi tashmë kanë plotësuar kapacitetet e tyre për të pranuar mbeturina. Duke marrë parasysh këtë fakt, është e domosdoshme që sa më shpejtë që është e mundur të ndërtohet një deponi tjetër e mbeturinave.

9. Rekomandime

- Të sigurohet implementimi i legjisllacionit të mjedisit si dhe zbatimi i politikave me qëllim që të arrihet një mjedis më i pastër;
- Të mbikëqyrët puna dhe përformanca e agjencive përgjegjëse dhe inspektorateve për mbrojtjen e mjedisit;
- Të sigurohet e drejta e qytetarëve për të pasur qasje në informata, e drejta në vendimmarrje në vendet ku ata jetojnë si dhe e drejta për qasje në drejtësi;
- Të parandalohen dhe të ndëshkohen kryesit e operimeve ilegale në mjedis;
- Të sekuestrohen mjetet e rënda të eksploatuesve ilegale të rërës dhe zhavorrit.
- Të rritet bashkëpunimi midis Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial dhe inspektorateve të mjedisit;
- Të rriten gjobat si dhe të vendosen dënime shtesë me qëllim të ndalimit të operatorëve të cilët zhvillojnë aktivitete ilegale.
- Prokuroritë themelore të caktojnë prokurorë për fushën e mjedisit
- Të bëhet një vlerësim i dëmeve mjedisore që janë shkaktuar nga eksploatuesit e rërës dhe zhavorrit si dhe nga gurthyesit.

